



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 632/7 prot.

Tiranë, më 16.12.2022

VENDIM

Nr. 933 Datë 16.12.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SELFNEST D.O.O. NGA SHOQËRIA NELT CO. D.O.O. DOBANOVCI”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.12. 2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë SelfNest d.o.o. nga shoqëria Nelt Co. D.o.o. Dobanovci.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë SelfNest d.o.o. nga shoqëria Nelt Co. D.o.o. Dobanovci,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë SelfNest d.o.o. nga shoqëria Nelt Co. D.o.o. Dobanovci.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e Transferimit të Interesit të Pjesëmarrjes”, palët në transaksion janë:

Blerësi: Nelt Co. d.o.o Dobanovci, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në regjistrin e Gjykatës Ekonomike të Beogradit, me objekt aktiviteti: shitjen me shumicë të sheqerit, çokolllatave dhe ëmbëlsirave; distribucionin dhe tregtinë me shumicë të mallrave, logjistikës dhe të marketingut tregtar tek konsumatori. Shoqëria Nelt CO d.o.o Dobanovci është pjesë e Grupit Nelt.

Grupi Nelt ofron shërbime të integruara të distribucionit dhe logjistikës tek konsumatorët e tij të brendshëm dhe ndërkombëtar, përmes një rrjeti qendrash distribucioni dhe mbështetjesh operacionale. Grupi NELT është kryesisht aktiv në distribucionin e mallrave të konsumit, por ofron edhe shërbime të tjera si: distribucioni i produkteve farmaceutike, ndërmjetësim dhe logjistikë, si edhe është aktiv në industrinë e mishit.

Grupi Nelt ka një filial në Shqipëri, shoqërinë Nelt SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti import-eksporti dhe tregtimi me shumicë dhe me pakicë i të gjithë artikujve industrialë, të konsumit të gjerë, ushqimore, kinkalerie, tregtim i produkteve kozmetike, farmaceutike dhe i karburanteve të ndryshme etj.

Nelt SHPK është në pronësi të plotë të Neregelia Trading Limited, një shoqëri qipriote, shoqëria mëmë e Grupit Nelt.

Shitësi: Dejan Čogurić, person fizik, shtetas i huaj, i cili zotëron 100% SelfNest d.o.o.

Target: SelfNest d.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Serbisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin e projekteve të ndërtimit në Serbi.

SelfNest d.o.o. nuk ka asnjë filial dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi

Më datë 26 shtator 2022, shoqëria Nelt Co. d.o.o Dobanovci (Blerësi) dhe Dejan Čogurić (shitësi) kanë nënshkruar “Marrëveshje e Transferimit të Interesit të Pjesëmarrjes”.

Referuar kësaj marrëveshjeje, Dejan Čogurić (shitësi) zotëron 100% të interesit të pjesëmarrjes (aksioni serb) në SelfNest d.o.o. Shitësi nëpërmjet kësaj marrëveshjeje transferon dhe blerësi fiton Interesin e Pjesëmarrjes të lirë dhe të pastër nga çdo barrë, së bashku me çdo të drejtë dhe interesa që rrjedhin prej tij. Shitësi deklaron në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar së është dakort që blerësi, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, të regjistrohet në Agjencinë Serbe të Regjistrimit të Shoqërive si pronar i vetëm i Interesit të Pjesëmarrjes.

Në përfundim të transaksionit, Nelt Co. d.o.o Dobanovci do të zotërojë 100% shoqërinë SelfNest d.o.o.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë SelfNest d.o.o nga shoqëria Nelt Co. d.o.o Dobanovci, parashikuar në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i

produktit do të konsiderohet tregu i pasurive të paluajtshme, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Nelt Co. d.o.o. Dobanovci, i përket grupit të shoqërive Nelt. Aktivitetet kryesore të NELT janë në distribucion dhe tregti me shumicë e mallrave, ndërkohë që shoqëria SelfNest d.o.o operon në tregun e pasurive të paluajtshme, duke mos krijuar mundësitë e një mbivendosje mes aktiviteteve të tyre.

Nëpërmjet shoqërisë Neregelia Trading Limited, grupi NELT është prezentë në Shqipëri nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej saj Nelt SHPK, i cili operon në tregun e shitjes me shumicë, ndërkohë që shoqëria SelfNest d.o.o nuk ka asnjë filial dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,


VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë SelfNest d.o.o. nga shoqëria Nelt Co. d.o.o. Dobanovci.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS


Leida MATJA


Zv/Kryetar


Rezana KONOMI


Anëtar

Adriana BERBERI


Anëtar

Durim KRAJA


Anëtar

